

Data 28.08.2026

Procesverbal - Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: **“Blerje Uniforma dhe veshje për stafin”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Bluza dhe
këmisha: 18330000-1; Këmisha: 18332000-5;

Vlera e fondit limit: 2,338,367 (dy milion e treqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e
gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë, pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik”, e ndryshuar me VKM-në nr.714, datë 24.11.2021 autoriteti/enti kontraktor Identitek
sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe
kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtocës 9

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; përkatësisht në 46.767,34 (dyzet e gjashtë mijë e
shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë presje tridhjetë e katër) leke*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM
nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Certifikate **ISO 9001:2015** (ose të përditësuar
dhe/ose ekuivalent), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të
prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë të kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilesor të tij.

2.2 Kapaciteti ekonomiko-financiar

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
 - b. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi

zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim Prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar prej Prodhuesit, për të gjithë mallrat, objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikat 6 dhe 8, të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vlerëson se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave objekt kontrate, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet e kërkuara.

Konkretisht kjo kërkesë është vendosur :

1. për të rritur sigurinë dhe bindjen e AK se ofertuesit janë të aftë të realizojnë kontratën në rast se shpallen fitues si dhe
2. për të garantuar AK se oferta teknike është e bazuar në produkte reale të identifikuara nga ofertuesit.

Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së ofertuesve për përmbushjen me sukses të kontratës.

Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se, ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale dhe produkteve/shërbimeve më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit, si dhe për të garantuar AK se oferta teknike është e bazuar në produkte reale të identifikuara nga ofertuesit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të

vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mallrat objekt prokurimi katalog dhe/ose skedë teknike, në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e specifikimeve teknike të mallrave të ofertuara me specifikimet teknike të kërkuara nga AK.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të artikujve të ofertuara me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, për artikujt/ produktet që oferton.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë nga një mostër, për të gjithë mallrat objekt prokurimi pranë Identitek sh.a, në datën dhe orën e hapjes së ofertave. Për mallrat që kërkohet të jenë të loguara sipas shtojcës 6, duhet të paraqiten mostra të loguara. Mostrat e kërkuara më sipër, duhet të kenë një etiketë të qepur, e cila të përmbajë: mostër "emri i artikullit", datën e zhvillimit të tenderit, emrin dhe vulën e prodhuesit në etiketën e mostrës/ ofertuesit. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

Mosparaqitja e tyre përbën kusht për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e mostrave si më sipër është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Autoriteti kontraktor ka gjykuar të arsyeshme paraqitjen e mostrave për artikujt objekt prokurimi, të përcaktuara si më sipër, duke marrë në konsideratë sasinë e tyre, vlerën e fondit limit, llojin e mallit që kërkohet konkretisht specifikimet e ndryshme që ka secili artikull objekt prokurimi. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentet e tenderit. Kjo përfshin verifikimin e cilësisë së materialit të produktit final, dizenjimin e uniformave, dimensionet e kërkuara, si dhe karakteristika të tjera që lidhen me aksesoret që kanë këto artikuj, të cilat nuk mund të verifikohen përmes dokumenteve të tjerë të kërkuara. Përfshirja e mostrave rrit transparencën dhe objektivitetin, duke i dhënë komisionit të vlerësimit një bazë të qartë për të krahasuar ofertat dhe për të marrë një vendim të drejtë. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në

fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike të përcaktuara për artikujt objekt prokurimi janë hartuar në përputhje me nevojat konkrete të Autoritetit Kontraktor për pajisjen e punonjësve me veshje pune të përshtatshme, funksionale, rezistente dhe të unifikuara nga pikëpamja e paraqitjes institucionale.

Në përcaktimin e karakteristikave teknike është marrë në konsideratë fakti se veshjet do të përdoren në mënyrë të vazhdueshme gjatë ushtrimit të detyrave të punonjësve dhe, për rrjedhojë, duhet të sigurojnë njëkohësisht **komfort gjatë përdorimit, qëndrueshmëri, rezistencë ndaj larjeve të shpeshta, ruajtje të formës dhe ngjyrës, si dhe identifikim të qartë të punonjësve të Autoritetit Kontraktor.**

1. Këmishë meshkujsh – mëngë të gjata

Kërkesa për këmishë për meshkuj me mëngë të gjata, model “classic fit”, është përcaktuar për të siguruar një veshje pune me prerje funksionale dhe komode, të përshtatshme për përdorim gjatë një kohe të zgjatur pune dhe për kategori të ndryshme trupore të punonjësve.

Përbërja e rekomanduar prej **80% pambuk dhe 20% poliestër**, me gramaturë **120–140 gr/m²**, synon të krijojë një raport të përshtatshëm ndërmjet komfortit dhe rezistencës. Përmbajtja e lartë e pambukut ndihmon në ajrosjen dhe komoditetin e veshjes, ndërsa përmbajtja e poliestërit kontribuon në rritjen e qëndrueshmërisë mekanike, ruajtjen e formës dhe reduktimin e konsumimit nga larjet dhe përdorimi i përsëritur.

Jakë klasike e fortifikuara, mbyllja me kopsa dhe qepjet e dyfishta në zonat e ekspozuara ndaj konsumimit janë kërkuar për të rritur jetëgjatësinë dhe qëndrueshmërinë e produktit.

Ngjyrat **e bardhë dhe blu e errët (Navy Blue)** janë përcaktuar në funksion të unifikimit të paraqitjes së personelit, ndërsa vendosja e logos dhe vijave identifikuese shërben për identifikimin vizual dhe institucional të punonjësve gjatë ushtrimit të detyrës.

2. Këmishë femrash – mëngë të gjata

Për këmishën e femrave është përcaktuar modeli “slim/classic fit”, me mëngë të gjata, me qëllim sigurimin e një prerjeje ergonomike dhe të përshtatshme për uniformën e punës.

Edhe për këtë artikull, përbërja e rekomanduar **80% pambuk dhe 20% poliestër**, me gramaturë **120–140 gr/m²**, është përcaktuar për të garantuar një balancë ndërmjet butësisë, ajrosjes, komoditetit dhe rezistencës së materialit gjatë përdorimit të përditshëm.

Kërkesa për jakë klasike, mbyllje ballore me kopsa dhe kopsa në fund të mëngëve lidhet me funksionalitetin dhe paraqitjen e rregullt të uniformës. Logoja “IdentiTek” dhe elementët identifikues në pjesën e majtë të kraharorit shërbejnë për evidentimin e përkatësisë institucionale.

Kërkesa që copa të jetë rezistente ndaj rrudhosjes, larjeve të shpeshta dhe zbehjes së ngjyrës është e nevojshme për shkak të përdorimit të vazhdueshëm të veshjes dhe nevojës për ruajtjen e një paraqitjeje të rregullt profesionale gjatë gjithë periudhës së përdorimit.

3. Polo femrash – mëngë të shkurtra

Bluza polo për femra është parashikuar si pjesë e uniformës së punës për periudhat dhe ambientet ku kërkohet një veshje më e lehtë dhe funksionale.

Përbërja e rekomanduar prej **85% pambuk dhe 15% poliestër**, me gramaturë **180–220 gr/m²**, është përcaktuar për të siguruar një material relativisht të trashë dhe rezistent, pa cenuar komoditetin dhe ajrosjen gjatë përdorimit. Gramatura e përcaktuar kontribuon gjithashtu në ruajtjen e formës së bluzës dhe në qëndrueshmërinë e saj ndaj përdorimit dhe larjeve të përsëritura.

Modeli “slim/classic fit”, jaka polo dhe mbyllja me tre kopsa përbëjnë elemente funksionale dhe estetike karakteristike të këtij lloji uniforme.

Prodhimi në variantin e bardhë dhe Navy Blue, së bashku me logon dhe vijat identifikuese me ngjyrë të kundërt, është kërkuar për të ruajtur një paraqitje të unifikuar dhe identitet të dallueshëm të personelit.

4. Polo meshkujsh – mëngë të shkurtra

Bluza polo për meshkuj është përcaktuar me model “classic fit”, për të mundësuar liri të përshtatshme lëvizjeje dhe komoditet gjatë kryerjes së detyrave.

Përbërja e rekomanduar prej **85% pambuk dhe 15% poliestër**, me gramaturë **180–220 gr/m²**, është përcaktuar duke konsideruar përdorimin e shpeshtë të artikullit. Pambuku siguron komfort dhe ajrosje, ndërsa poliesteri përmirëson rezistencën, qëndrueshmërinë e formës dhe jetëgjatësinë e produktit.

Jaka polo me detaje vijash, mbyllja me tre kopsa dhe elementët identifikues janë kërkuar për të kombinuar funksionalitetin e veshjes me paraqitjen institucionale të personelit.

Rezistenca ndaj rrudhosjes, larjeve të shpeshta dhe zbehjes së ngjyrës konsiderohet e domosdoshme për të garantuar që artikulli të ruajë karakteristikat funksionale dhe estetike gjatë gjithë periudhës së përdorimit.

5. Përparëse për sanitaret

Përparësja për sanitaret është përcaktuar në funksion të natyrës së veçantë të punës së këtij personeli dhe nevojës për një veshje mbrojtëse, praktike dhe lehtësisht të dallueshme gjatë kryerjes së shërbimit.

Modeli pa mëngë, me gjatësi deri te gjuri, jakë klasike dhe mbyllje ballore me kopsa mundëson veshje dhe heqje të lehtë, liri në lëvizje dhe përdorim praktik gjatë realizimit të proceseve të pastrimit dhe mirëmbajtjes.

Përbërja e rekomanduar prej **65% poliestër dhe 35% pambuk**, me gramaturë **150–170 gr/m²**, është përcaktuar duke marrë në konsideratë karakterin intensiv të përdorimit të kësaj veshjeje. Përqindja më e lartë e poliestërit rrit rezistencën ndaj konsumimit, larjeve të shpeshta dhe deformimit, ndërsa pambuku kontribuon në komfortin gjatë përdorimit.

Xhepat e përparmë janë parashikuar për arsye funksionale, duke mundësuar mbajtjen e mjeteve ose materialeve të vogla të nevojshme gjatë kryerjes së detyrës.

Ngjyra **Navy Blue**, së bashku me logon e bardhë, mundëson identifikimin e personelit dhe njëkohësisht konsiderohet e përshtatshme për natyrën e punës së sanitareve, pasi ruan më mirë paraqitjen vizuale gjatë përdorimit të përditshëm.

Argumentimi i përbashkët i kërkesave teknike

Në tërësi, përcaktimi i përbërjes së materialeve, gramaturave, modeleve, qepjeve, ngjyrave dhe elementëve identifikues është bërë duke marrë në konsideratë **destinacionin e përdorimit, intensitetin e përdorimit të veshjeve, kushtet e punës, nevojën për komfort dhe liri lëvizjeje, si dhe domosdoshmërinë për jetëgjatësi të arsyeshme të artikujve.**

Kërkesat për rezistencë ndaj **rrudhosjes, larjeve të shpeshta dhe zbehjes së ngjyrës** lidhen drejtpërdrejt me faktin se bëhet fjalë për veshje pune, të cilat do t'i nënshtrohen cikleve të vazhdueshme të përdorimit dhe mirëmbajtjes. Për këtë arsye, është e nevojshme që artikujt të ruajnë formën, ngjyrën dhe paraqitjen e tyre edhe pas përdorimit të përsëritur.

Gjithashtu, përdorimi i **logos dhe elementëve grafikë identifikues** argumentohet me nevojën për unifikimin e uniformës dhe identifikimin e menjëhershëm të personelit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, duke kontribuar në paraqitjen e rregullt dhe profesionale të Autoritetit Kontraktor.

Specifikimet teknike janë përcaktuar mbi bazën e karakteristikave funksionale dhe të performancës që duhet të përmbushin artikujt dhe synojnë sigurimin e produkteve me cilësi dhe qëndrueshmëri të përshtatshme për destinacionin e tyre, duke garantuar njëkohësisht përdorimin racional dhe ekonomik të fondeve të Autoritetit Kontraktor.

Fotografitë e vendosura në specifikimet teknike kanë **karakter orientues/ilustrues**, me qëllim evidentimin e modelit dhe paraqitjes së përgjithshme të kërkuar dhe nuk duhet të interpretohen si kërkesë për një markë, prodhues apo origjinë të caktuar. Artikujt e ofruar duhet të plotësojnë karakteristikat teknike, funksionale dhe cilësore të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:

Data: **11.09.2026 ora 11:00**